



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 155 Prot

Tiranë, më 15.02.2023

V E N D I M

Nr. 16, datë 15.02.2023

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN MINISTRIA E
KULTURËS DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR
PARREGULLSITË E KONSTATUARA**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraparak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Ministria e Kulturës,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 106 (570 prot.), datë 15.7.2022, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatin e Ministrisë së Kulturës”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë kryerjes së procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatin e Ministrisë së Kulturës, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, nga zyrtarët e ngarkuar prej ligjit për realizimin e këtij procesi.

Referuar parashikimeve të nenit 7, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe nenit 4 e nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për

organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ministritë janë pjesë e institucioneve të administratës shtetërore dhe struktura dhe organika e tyre përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

Vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, lidhja nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në ndarjen 2, ka parashikuar në mënyrë të shprehur se *“aparartet e ministrive”*, përfshihen në shërbimin civil si pjesë e institucioneve të administratës shtetërore.

Objekti i mbikëqyrjes është tematik dhe përfshin kontrollin dhe vlerësimin e veprimeve administrative të kryera nga zyrtarët e ngarkuar me detyrën për të kryer procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë të aparatit të ministrisë, për periudhën korrik - dhjetor 2021 dhe janar - qershor 2022.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 570/1 prot., datë 15.7.2022, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 570/2 prot., datë 15.7.2022, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Ministrinë e Kulturës”*, i është njoftuar institucionit të mbikëqyrur.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë, i cili me shkresën nr. 570/3 prot., datë 24.11.2022 të Komisionerit, i është dërguar për njohje Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, duke i lënë 30 ditë kohë, për të paraqitur observacionet.

Institucioni i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin me shkresën nr. 6571/2 prot., dt. 27.12.2022, lënda *“Mbi pretendimet dhe sqarimet në lidhje me Projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Ministria e Kulturës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, gjatë procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, ka dërguar të nënshkruar projektraportin së bashku me disa sqarime në lidhje me vlerësimin e nëpunësve civilë të cilët kishin vlerësime të pjesshme por nuk kishin vlerësim përfundimtar, si dhe vlerësimin e një nëpunësi i cili nuk ishte përfshirë në procesin e vlerësimit duke mos paraqitur vërejtje lidhur me gjetjet e trajtuara në pjesët respektive të projektraportit. Shkresës i është bashkëlidhur dokumentacioni përkatës.

Gjithashtu, me shkresën nr. 570/4 prot., datë 24.11.2022, të Komisionerit, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje edhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për institucionin e mbikëqyrur.

Njësia përgjegjëse DAP, pasi është njohur me projektraportin me shkresën nr. 6481/1 prot., datë 3.2.2023, me lëndë “*Mbi projektraportet përfundimtare të mbikëqyrjes në shërbimin civil*”, informon Komisionerin se, në zbatim të detyrave të lëna në projektraport ka nisur procesin e vlerësimit të nëpunësve civilë anëtarë të TND-së dhe më tej, procedura e vlerësimit për këtë kategori nëpunësish është përmbysur nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për një kategori të caktuar nëpunësish në disa institucione të mbikëqyrura. Nga ana tjetër, në këtë rast konstatohet se, njësia përgjegjëse DAP, nuk ka dërguar materiale shkresore e asnjë akt administrativ për të provuar përfundimin e procedurës së vlerësimit të anëtarëve të TND-së, nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes.

Për këtë arsye, verifikimi i veprimeve administrative të kryera nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për kryerjen e procedurës së vlerësimit të nëpunësve anëtarë të TND-së, të cilët aktualisht janë pjesë e aparatit të Ministrisë së Kulturës, do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm nga ana e Komisionerit në përfundim të afatit të vendosur për zbatimin e detyrave të lëna në këtë vendim.

Lidhur me gjetjet e grupit të punës të trajtuara në pjesët respektive të projektraportit institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse DAP nuk kanë paraqitur vërejtje. Sqarimet e dërguara prej tyre, janë administruar në dosjen e mbikëqyrjes dhe janë trajtuar në pjesët respektive të raportit përfundimtar.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar dhe nëpunësve të përmendur në përmbajtjen e materialeve për parregullsi, për të shprehur pretendimet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatit të Ministrisë së Kulturës, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit

nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Zyrtarët raportues të marrin masa që në vlerësimet pasardhëse të punës e në vijim, gjatë plotësimit të formularit të vlerësimit për çdo nëpunës dhe për të gjitha nivelet e vlerësimit, të plotësojnë hapësirat përkatëse të dedikuara për komente dhe shpjegime.
3. Në rastin e vlerësimeve të pjesshme për shkak të largimit të zyrtarëve që duhet të bëjnë vlerësimin, zyrtari raportues zëvendësues që përmbyll procesin e vlerësimit duhet të bëjë vlerësim përfundimtar për gjithë periudhën 6 mujore të vlerësimit.
4. Zyrtarët raportues të identifikojnë kërkesat e nëpunësve të vlerësuar për trajnim dhe mundësi zhvillimi të veçantë profesional, të hartojnë rekomandimet përkatëse për trajnimin e tyre dhe më tej t’i paraqesin për miratim pranë Zyrtarit autorizues.
5. Zyrtarët kundërfirmues si mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të zyrtarëve raportues, të sigurojnë një vlerësim objektiv të nëpunësve si dhe ky vlerësim të pasqyrojë kriteret e politikës së përgjithshme.
6. Zyrtarët kundërfirmues të mbajnë kontakte të rregullta me zyrtarët raportues, të identifikojnë nevojat e tyre për trajnim duke i adresuar ato pranë Zyrtarit autorizues për të siguruar një ecuri normale të sistemit të vlerësimit.
7. Zyrtari autorizues si përgjegjësi kryesor i sistemit të vlerësimit, të sigurojë që të gjithë zyrtarët raportues dhe kundërfirmues të kenë njohuri të plota për realizimin e procedurës së vlerësimit. Të vlerësohen nevojat për trajnimin e zyrtarëve raportues dhe zyrtarëve kundërfirmues me qëllim që procedura e vlerësimit të realizohet në përputhje me standartet e kërkuara nga vendimi nr. 109, datë 26.2.2014, i Këshillit të Ministrave.
8. Të hartohet një plan trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta që ju vendos zyrtarëve të vlerësimit legjislativ i shërbimit civil. Ky plan t’i njoftohet zyrtarisht njësisë përgjegjëse DAP dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), të cilët bazuar në çështjet konkrete të adresuara të bëjnë të mundur ndjekjen e trajnimeve të veçanta.
9. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të përfshijë në Regjistrin Qendror të Personelit formularin e vlerësimit për çdo nëpunës civil siç përcaktohet në pikën 18, kreu II, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Formulari i vlerësimit të çdo nëpunësi civil të administrohet në dosjen e personelit si një e dhënë e përgjithshme që lidhet me marrëdhënien e punës, siç parashikohet në

pikën 1, kreu II, të vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”.

10. Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, të drejtore procesin e vlerësimit për TND-në, në mënyrë që formulari i vlerësimit i plotësuar dhe i nënshkruar nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes, t’i përcillet zyrtarisht nëpunës *****, anëtare e TND-së, e cila aktualisht është e emëruar në aparatën e Ministrisë së Kulturës.

Nëpunësja e vlerësuar të nënshkruajnë duke deklaruar marrjen dijeni, si dhe dakordësinë apo mosdakordësinë e saj lidhur me vlerësimin e kryer. Më tej formulari i vlerësimit të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit dhe të administrohet në dosjen e personelit si një e dhënë e përgjithshme që lidhet me marrëdhënien e punës.

11. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit dhe njësia përgjegjëse DAP, të informojnë të gjithë aktorët e procesit të vlerësimit në institucion dhe KKP-në, për këtë vendim dhe Raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, me qëllim që të zbatojnë detyrat e lëna nga Komisioneri. Në përfundim të afatit përgjegjësia do të jetë personale për çdo zyrtar që nuk ka zbatuar detyrat e ngarkuara prej ligjit.

Zyrtarët e ngarkuar me procesin e vlerësimit, mund të njihen me përmbajtjen e këtij vendimi dhe Raportin përfundimtar të mbikëqyrjes edhe nëpërmjet faqes zyrtare të Komisionerit, në adresën www.kmshc.al.

12. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **5 (pesë) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim, me qëllim që zyrtarët e ngarkuar me procesin e vlerësimit, Zyrtari raportues, Zyrtari kundërfirmues, Zyrtari autorizues, Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për TND-në dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të kenë mundësi që të zbatojnë detyrat e lëna në këtë vendim dhe në Raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, gjatë kryerjes së procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë që do të realizohet për 6 muajin e parë të vitit 2023.

13. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Ministria e Kulturës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

14. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil,

nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

15. Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Kulturës dhe Departamenti i Administratës Publike, duke iu dërguar një kopje të vendimit dhe një kopje të Raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA